

# NJOFTIM MBI ANULIMIN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT

*Në përputhje me nenin 47 të “Rregullës për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës” (1 dhjetor 2024)*

Data: 11.12.2025

I. “Banka Qendrore e Republikës së Kosovës”  
Adresa: Rr. “Garibaldi” 33, 10000 Prishtinë

II. Lënda e procedurës së prokurimit:

II.1 Titulli i kontratës: “**Shërbime të pastrimit të objekteve të BQK-së**”

II.2 Numërtimi i prokurimit: “BQK 25 069 221”

II.3 Lloji i procedurës: *Procedurë e hapur*

II.4 Lloji i prokurimit: Shërbim

II.5 Numri i tenderëve të pranuar: 1 (një)

III. Anulimi i procedurës së prokurimit:

III.1 Data e anulimit të procedurës: 11.12.2025

III.2 Arsyeja e anulimit: Anulimi i kësaj procedure të prokurimit është bërë në përputhje me “Rregullën për Prokurimin në BQK”, konkretisht sipas nenit 47, paragrafët 2 dhe 3. Vendimi i Bankës Qendrore për anulim është në pajtim me parimet e përcaktuara në nenin 4 të kësaj Rregulle, për arsye të tejkalimit të buxhetit të parashikuar për këtë kontratë.

IV. Ankesat

Në përputhje me “Rregullën për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës” (1 dhjetor 2024), respektivisht sipas Neni 48 “Procedura e ankesës”, çdo palë e interesuar<sup>1</sup> mund të bëjë ankesë pranë Bankës Qendrore: Rr. “Garibaldi” 33, 10000 Prishtinë, [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org), brenda 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij njoftimi. Ankesa nga pala e interesuar duhet të përmbajë të gjitha elementet e cekura si në dosjen e tenderit dhe fizikisht duhet të dorëzohet në Arkivin e BQK-së brenda afatit për t’u konsideruar e vlefshme. Pala ankuese duhet të paguajë një tarifë për parashtrim të ankesës pranë Bankës Qendrore, vlera e së cilës do të jetë deri në 1% të vlerës së ofertës përkatëse, jo më pak se 100 euro dhe jo më shumë se 2,500 euro. Në të kundërtën

---

<sup>1</sup> “Palë e interesuar”, sipas pikës 1.26 të nenit 2 të “Rregullës për Prokurimin në BQK” cilësohet operatori ekonomik që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i një aktiviteti të prokurimit të zbatuar nga Banka Qendrore në raport me një kontratë të prokurimit.

refuzohet menjëherë nga ana e BQK-së. Ankesa e parashtruar pa dëshminë e pagesës që duhet të sigurohet nga pala ankuese do të refuzohet që në pranim të parë nga Banka Qendrore.